



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Lënda: Psikologji

Shkalla: VI

Klasa: XII

Tiranë 2017



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Tabela e përmbajtjes

| | |
|--|----|
| Tabela e përmbajtjes | 2 |
| Lista e tabelave | 4 |
| Hyrje | 5 |
| Korniza konceptuale e programit të psikologjisë..... | 7 |
| 1.1 Qëllimet e programit të psikologjisë | 7 |
| 1.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës /lëndës | 10 |
| 1.2.1 Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit | 11 |
| 1.2.2 Kompetenca e të menduarit | 11 |
| 1.2.3 Kompetenca e të mësuarit | 12 |
| 1.2.4 Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin..... | 13 |
| 1.2.5 Kompetenca personale | 14 |
| 1.2.6 Kompetenca qytetare | 14 |
| 1.2.7 Kompetenca digjitale | 15 |
| 1.3 Lidhja e lëndës së psikologjisë me temat ndërkurrikulare | 15 |
| 1.4 Lidhjet e lëndës së psikologjisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit | 17 |
| 1.4.1 Gjuhët dhe komunikimi | 17 |
| 1.4.2 Matematika | 18 |
| 1.4.3 Shkencat e natyrës..... | 18 |
| 1.4.4 Shoqëria dhe mjedisi..... | 18 |
| 1.4.5 Arte | 19 |
| 1.4.6 Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti | 19 |

| | | |
|-------|---|----|
| 1.4.7 | Teknologji dhe TIK..... | 20 |
| 1.5 | Kompetencat e fushës/lëndës dhe tematikat e saj | 20 |
| 1.6 | Koha mësimore për tematikë..... | 22 |
| | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave të lëndës | 24 |
| | Udhëzime metodologjike | 33 |
| | Udhëzime për vlerësimin | 36 |
| | Materialet dhe burimet mësimore | 39 |

Lista e tabelave

| | |
|---|----|
| Tabela 1. Korniza konceptuale e programit të psikologjisë..... | 9 |
| Tabela 2. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së psikologjisë..... | 11 |
| Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës | 20 |
| Tabela 4. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Studimi i psikologjisë..... | 24 |
| Tabela 5. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Biopsikologjia | 25 |
| Tabela 6. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Zhvillimi..... | 27 |
| Tabela 7. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Njohja | 29 |
| Tabela 8. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Variacionet midis individëve dhe grupeve..... | 31 |

Hyrje

Shumica e problemeve të vështira të shoqërisë, duke përfshirë krimin, varfërinë, paragjykimet, aktet e dhunës janë të lidhura me qëndrimet e njeriut, vlerat dhe sjelljen e tij.

Shkenca e psikologjisë, në bashkëpunim me fushat e tjera të shkencave shoqërore, informon të kuptuarit tonë rreth këtyre problemeve dhe zgjidhjen e tyre. Duke marrë parasysh se psikologjia ka një potencial për t'i bërë njerëzit të përfitojnë nga ajo dhe për të përmirësuar mënyrën e jetesës së tyre, një hyrje në shkencën psikologjike meriton përfshirjen në programin mësimor për shkollat e mesme. Nxënësit frekuentues të këtij kursi hyrës në psikologji mund të aplikojnë njohuritë e përfituara në jetën e përditshme.

Psikologjia përkufizohet si studimi shkencor i mendjes dhe sjelljes. Në kursin e psikologjisë të shkollës së mesme, nxënësit njihen me metodën shkencore, idetë themelore dhe teoritë e psikologjisë. Si rezultat, nxënësit do të fitojnë një kuptim të kompleksitetit dhe diversitetin e mendimit dhe sjelljes njerëzore.

Nxitja e shëndetit dhe e sigurisë, e shkathtësive të të mësuarit dhe e produktivitetit në punë, e zhvillimit të fëmijës dhe të adoleshentit, e efektivitetit njerëzor në botën e sotme teknologjike dhe informative përbën një objektiv të përhershëm të një sistemi të efektshëm arsimor. Studimi i psikologjisë në shkollën e mesme i shërben këtij objektiv. Si shkencë e mendjes dhe e sjelljes, psikologjia përbën një pjesë të rëndësishme të formimit shoqëror të nxënësit të shkollës së mesme.

Përmes studimit të psikologjisë, nxënësit do të arrijnë të kuptojnë kompleksitetin e mendimit dhe të sjelljes si dhe faktorët që kushtëzojnë ndryshimet e individëve nga njëri-tjetri. Ata do të kuptojnë metodat e studimit të kësaj shkençe dhe do të mësojnë si t'i zbatojnë ndërgjegjësimet e fituara në jetën e tyre të përditshme. Lënda e psikologjisë do t'u japë mundësi nxënësve të shkollave të mesme të përvetësojnë njohuri dhe aftësi të reja që do t'u krijojë mundësinë e mbështetjes së zhvillimit personal e social të tyre.

Nxënësit do ta mësojnë lëndën e psikologjisë në mjedise të ndryshme: mjedisi i shkollës do të jetë vetëm njeri ndër ta. Kontaktet e nxënësve me të tjerët, me median, me klubet, panaiet, familjen, etj., do të shtojnë para tyre një numër shumë të madh çështjesh që përbëjnë shanse për përvetësim të mëtejshëm të njohurive psikologjike.

Realizuesi i këtij programi është mirë të mbajë parasysh mundësinë e shfrytëzimit të këtyre mjediseve, me qëllim që nxënësit jo vetëm të kuptojnë aftësitë, interesat dhe vlerat që kanë, por edhe të përpiqen të fitojnë pavarësi në marrjen e vendimeve dhe qëndrimeve të tyre.

Parimet themelore mbi të cilat shtjellohet lënda e psikologjisë në këtë program do të jenë:

- ekzaminimi empirik i sjelljes dhe i proceseve mendore;
- qëndrimi kritik ndaj dukurive psikologjike;
- kuptimi dhe toleranca ndaj diversitetit.

Shoqëria shqiptare po fragmentohet dhe po diversifikohet me shpejtësi dhe kjo është bota ku rritet nxënësi i shkollës së mesme. Programi i psikologjisë do të kontribuojë që të kuptohet e të respektohet diversiteti i pafundmë njerëzor dhe të zhvillohet përkatësisht aftësia e nxënësve për t'u mirëkuptuar në këtë botë dhe për të zhvilluar tolerancën e arsyeshme ndaj saj.

Mësuesi i lëndës së psikologjisë duhet t'i ndihmojë nxënësit e vet në mësimin e kësaj lënde përmes përdorimit të një numri të madh metodash si:

- demonstrimet në klasë;
- të nxënësve në bashkëpunim me të tjerët;
- projektet kërkimore;
- shërbimet për komunitetin.

Korniza konceptuale e programit të psikologjisë

1.1 Qëllimet e programit të psikologjisë

Psikologjia është një shkencë e grupit shoqëror dhe ka lidhje të shumta si me shkencat shoqërore ashtu edhe me ato natyrore. Themeli për një mësimdhënie cilësore të psikologjisë në shkollën e mesme është kuptimi, shprehja dhe përhapja e njohurive të psikologjisë si shkencë. Përtej këtij themeli mësimdhënia e psikologjisë e parashikuar në këtë program synon gjithashtu që të mbështesë rritjen e nxënësve, zhvillimin dhe përshtatjen e tyre në një botë që ndryshon me shpejtësi.

Ky program u ofron nxënësve njohuritë më të pranuar nga shkenca psikologjike, ato njohuri që i ndihmojnë ata në jetën e tyre dhe ato njohuri që janë të dëshirueshme prej nxënësve. Mësimdhënia cilësore e psikologjisë në shkollën e mesme dhe që kërkohet nga ky program, do të bazohet në pritshmëri të qarta për nxënësit, duke e vënë theksin në një të mësuar aktiv. Mësuesi që do ta realizojë do të kujdeset që ta pasurojë atë duket shfrytëzuar psikologjinë e nxënësit dhe duke iu përgjigjur karakteristikave të ndryshme të tyre.

Lënda e psikologjisë synon:

- a. t'u japë nxënësve njohuritë dhe t'u zhvillojë përmes tyre ndërgjegjësimet të domosdoshme për të kuptuar vetveten dhe të tjerët;
- b. t'u japë nxënësve mundësinë për të ndikuar (intensifikuar, modifikuar, ndryshuar) në marrëdhëniet e tyre me veten dhe me të tjerët;
- c. të zhvillojë aftësitë dhe prirjet për respektimin e diversitetit, si kusht për mirëqenien vetjake e sociale dhe për zhvillimin e potencialit njerëzor.

Përmes studimit të lëndës së psikologjisë, nxënësit duhet të jenë të aftë:

- për të shprehur kuptimin që kanë për proceset e fenomenet psikologjike sipas tematikës së mësimëve;

- për të dialoguar e për të debatuar me njëri-tjetrin për çështje të ndryshme të psikologjisë;
- për të trajtuar çështjet në mënyrë kritike e krijuese;
- për të bashkëpunuar e për të konkurruar;
- për të zbatuar frymën e tolerancës së arsyeshme dhe të mirëkuptimit.

Në mënyrë më të detajuar objektivat përshkruhen në secilën prej tematikave të lëndës.

Meqenëse fusha e psikologjisë është shumë fleksibël e nuk mund të dogmatizohet, mësuesve që do të punojnë me këtë program u kërkohet që të jenë sa më krijues në realizimin e tij. Qëndrimi i tyre krijues duhet të shihet në raport me mënyrën e realizimit të orëve që ai ka në dispozicion, me lirinë për të zgjedhur materiale të tjera zëvendësuese për veprimtaritë me karakter zbatues, me materialet shtesë që ata u sugjerojnë nxënësve, me listat e temave që u rekomandojnë e të tjera.

Ky program paraqet një vizion të asaj që nxënësit duhet të dinë dhe të jenë në gjendje për të bërë, pas përfundimit të kursit të psikologjisë së shkollës së mesme.



Tabela 1. Korniza konceptuale e programit të psikologjisë

1.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës /lëndës

Të mësuarit në psikologji do të provohet me vlerë pavarësisht nga rrugët e të nxënës që nxënësit zgjedhin të ndjekin. Psikologjia i inkurajon ata të jenë të hapur dhe të shqyrtojnë informacionin në mënyrë kritike. Duke marrë psikologjinë, studentët fitojnë besim më të madh për të sfiduar supozimet dhe një aftësi më të madhe për të kuptuar sjelljen njerëzore. Këto aftësi do t'i qëndrojnë në vend të mirë për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Psikologjia i ndihmon nxënësit të punojnë aty ku kufizohen gënjeshtrat dhe jep fakte që mund t'i ndihmojnë ata të merren me çështje personale në mënyra konstruktive. Nxënësit e psikologjisë shpesh kanë njohuri më të madhe se bashkëmoshatarët e tyre se si dhe pse ndodhin sjellje të veçanta. Nxënësit e psikologjisë zhvillojnë një magjepsje për kompleksitetin e sjelljes njerëzore.

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e modulit. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënës. Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Realizimi i kompetencave kyçe të kornizës kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe, me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të nxënës.

Tabela 2. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së psikologjisë

1.2.1 Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

(Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.)

Nxënësi:

- shpreh para një audience të caktuar, çështjet thelbësore të ngritura në një fjalim ose në një interpretim për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes së paku një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike etj.); (1)¹
- diskuton në grup, në mënyrë konstruktive duke dhënë informacion, argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog prej disa minutash, për një temë të caktuar në gjuhën amtare ose në një gjuhë të huaj; (2)
- shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim; (7)
- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar p.sh., për edukimin mediatic, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte, për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë; (8)
- përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënit (duke përfshirë edhe të nxënit në distancë) si dhe gjatë kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore. (9)

1.2.2 Kompetenca e të menduarit

(Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.)

Nxënësi:

¹ Numri bazuar në secilën nga kompetencat kyçe sipas Kurrikulës Bërthamë X-XII

- sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve ose para të tjerëve; (1)
- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë; (5)
- vlerëson cilësinë e informacioneve në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh., për ngrohjen globale, për diversitetin kulturor dhe etnik etj.), identifikon elementet kryesore, i diskuton me moshatarët, duke dhënë propozime konkrete për shfrytëzimin e shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global, duke shprehur qëndrimin personal; (6)
- përpunon në mënyrë kritike, informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarët dhe me të tjerët për çështjen e ngritur, “pro” ose “kundër” (martesat mes anëtarëve të një gjinie, dënimi me vdekje etj.). (7)

1.2.3 Kompetenca e të mësuarit

(Nxënësi mëson për të nxënë.)

Nxënësi:

- demonstroi shkathhtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënimit (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve etj.); (1)
- diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore (ose një problem nga jeta e përditshme ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarët), tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathhtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla; (2)

- shfrytëzon, në mënyrë të duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve; (3)
- shkruan një letër motivuese në të cilën arsyeton angazhimin e vet për pjesëmarrje në një prezantim ose konkurs nga një fushë e caktuar mësimore, duke vënë theksin në aftësitë dhe cilësitë personale; (6)
- menaxhon në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e punës etj.) gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme. (9)

1.2.4 Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

(Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.)

Nxënësi:

- ndërmerr iniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në plotësimin e detyrave, përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve, referuar projektit apo planit; (2)
- argumenton me shembuj konkretë lidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, prezanton vendimmarrjen personale referuar mundësive në dispozicion për arsimim/trajnim të mëtejshëm, mundësive personale dhe financiare, si dhe argumenton zgjidhjet për realizimin e planit personal të karrierës; (3)
- paraqet modelin e një drejtuesi të një ndërmarrjeje ose organizate, sipas imagjinatës personale dhe duke respektuar karakteristikat kryesore të një sipërmarrësi të suksesshëm; (5)
- paraqet kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar. (8)

1.2.5 Kompetenca personale

(Nxënësi bën jetë të shëndetshme.)

Nxënësi:

- demonstroi vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në jetën e përditshme, duke dalluar aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve të synuara personale; (1)
- tregon shkathtësi në organizimin e lojës me të tjerët, garave sportive apo aktiviteteve kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë aktiviteteve dhe gjatë jetës së përditshme; (2)
- shfaq në forma të ndryshme, empati për të tjerët, p.sh. merr pjesë në aktivitete bamirësie, ndihmon të moshuarit, të sëmurët etj. dhe përvojat e tilla i prezanton para të tjerëve; (3)
- zgjidh konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive, duke shqyrtuar alternativat, duke marrë vendime dhe duke shpjeguar zgjedhjet e bëra; (5)
- shfaq në forma të ndryshme, ndërgjegjësim për menaxhimin e emocioneve, stresit dhe konflikteve në situata të jetës së përditshme apo në situata të improvizuara me karaktere të ndryshme historike, aktuale, sociale etj. (7)

1.2.6 Kompetenca qytetare

(Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)

Nxënësi:

- prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit; (1)

- paraqet në forma të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; (4)
- ilustron me shembuj nga jeta e përditshme, praktikat e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimeve të shembujve ilustrues në këtë fushë; (5)
- prezanton në një debat me të tjerët ose në një formë tjetër të të shprehurit, masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave dhe parimeve të të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, duke veçuar shembuj konkretë të ndonjë aktiviteti (p.sh. aktivitete për promovimin e barazisë gjinore, shmangien ndaj paragjytimeve dhe diskriminimit, luftën ndaj varfërisë etj.). (7)

1.2.7 Kompetenca digjitale

(Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur risitë.)

Nxënësi:

- përdor programet e TIK-ut në mënyrë efektive për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënimit, duke përfshirë edhe të nxënimit në distancë; (1)
- ndërgjegjësohet mbi globalizmin dhe larmitë e kulturave, duke shkëmbyer me nxënësit e vendeve të ndryshme përvojat e vendit tonë. (8)

1.3 Lidhja e lëndës së psikologjisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, përmbajtja e të cilave lidhet me problematikat kryesore me të cilat përballet shoqëria e sotme. Trajtimi i tyre synon njohjen e disa njohurive specifike, zotërimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit. Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat kurrikulare të të nxënimit, ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të forcojë lidhjen e shkollës me jetën dhe

interesat e saj. Temat ndërkurrikulare përcaktohen sipas politikave kombëtare afatmesme e afatgjata dhe konkretizohen e zërthehen në nivel vendor e në bazë shkolle. Temat ndërkurrikulare janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore.

Mendimet dhe veprimet individuale ndikojnë në normat dhe praktikat kulturore gjatë kohës që ato evoluojnë dhe me kalimin e kohës këto norma dhe praktika kulturore ndikojnë në mendimet dhe veprimet e nxënësve. Në këtë mënyrë programi zhvillon edukimin për identitetin kombëtar dhe njohjen e kulturave.

Programi gjithashtu promovon edukimin për të drejtat e njeriut duke nxitur komunikimin dhe zbatimin e njohurive psikologjike për të përfituar shoqëria dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve. Programi trajton problemet themelore të mirëqenies njerëzore dhe të drejtësisë sociale dhe të nxisë trajtimin e barabartë dhe të drejtë të të gjitha segmenteve të shoqërisë përmes edukimit.

Vendimmarrja morale është një temë tjetër kurrikulare që promovohet nëpërmjet programit të psikologjisë, ku proceset njohëse kanë një ndikim shumë të madh në vendimmarrjen morale.

Zhvillimi i qëndrueshëm i referohet përdorimit të burimeve natyrore në mënyrë të tillë që toka të vazhdojë të plotësojë nevojat e të gjithë njerëzve dhe gjeneratave të ardhshme. Psikologjia, si shkenca e sjelljes njerëzore, mund të luajë një rol të rëndësishëm në kuptimin dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky program ndihmon për të parë në një këndvështrim tjetër situatën aktuale globale, diskutimet mbi konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Programi i psikologjisë gjithashtu edukon nxënësit për t'u fokusuar në bashkëveprimin midis individëve dhe mjedisit të tyre. Nxënësi nëpërmjet programit synon zgjidhjen e problemeve komplekse mjedisore (mjediset natyrore, mjediset shoqërore, mjediset e të mësuarit, mjediset informative, etj.) në ndjekjen e mirëqenies individuale brenda një shoqëria më të gjerë. Ky program ndihmon në hartimin, menaxhimin, mbrojtjen dhe/ose rivendosjen e mjedisëve që rrisin sjelljen e arsyeshme, parashikojnë rezultatet e mundshme kur këto kushte nuk plotësohen, dhe diagnostikojnë situatat problematike.

Programi i psikologjisë nxit nxënësit të përdorin parimet që rrjedhin nga shkenca psikologjike dhe përvoja për të lëvizur institucionet, grupet dhe shoqëritë drejt barazisë më të madhe nëpërmjet përfshirjes sociale, politike dhe ekonomike të secilit brenda një kulture të përbashkët paqeje dhe ndërgjegjësohet për ndërvarësinë. Nëpërmjet këtij programi nxënësit do të rrisin ndjeshmërinë, mbështetjen, respektin për dallimet dhe zgjidhjen jo të dhunshme të problematikave kontradiktore.

1.4 Lidhjet e lëndës së psikologjisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

1.4.1 Gjuhët dhe komunikimi

Psikologjia lidhet ngushtësisht me fushën e gjuhëve dhe komunikimit duke qenë se mund t'i ndihmojë nxënësit dhe t'i nxisë ata drejt eksplorimit të strategjive efikase të komunikimit dhe përdorimit të gjuhës për të rritur arritjet e tyre akademike.

1.4.2 Matematika

Ashtu sikurse matematika dhe psikologjia kërkon analizën e të dhënave dhe eksplorimin dhe përdorimin e modeleve dhe marrëdhënieve në të dhëna. Ashtu si matematika dhe statistikat, ajo thekson mendimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe hetimin, interpretimin, shpjegimin dhe kuptimin e botës në të cilën jetojmë.

Nxënësit mund të përdorin projekte kërkimore psikologjike si kontekste për zbatimin praktik të aftësive të tyre matematikore, për shembull, duke krahasuar grupe të ndryshme të rezultateve. Aplikimi i njohurive të tyre për statistikat në një kontekst të vërtetë dhe interesant ka të ngjarë të angazhojë nxënësin dhe të ndërtojë besimin e tyre.

1.4.3 Shkencat e natyrës

Fizika

Sikurse psikologjia dhe fizika mbështetet në testimin e ideve me provat e fituara nga bota natyrore dhe fizike. Psikologjia dhe fizika gjithashtu lidhen pasi faktet shkencore pranohen si të vlefshme vetëm kur ato i janë nënshtruar testeve, përdorin qasje të shumëfishta, kreative dhe logjike

Ashtu si psikologjia, edhe fizika ka të njëjtën metodologji shkencore: marrja në pyetje, hetimi, kuptimi dhe shpjegimi, gjenerimin dhe testimin e ideve, mbledhjen e provave dhe komunikimin dhe debatin me të tjerët në mënyrë që të zhvillojnë njohuri, mirëkuptim dhe sqarim shkencor.

Biologji dhe kimi

Aspektet neurologjike të psikologjisë përshtaten në mënyrë të përkryer me tema të shkencës (biologjisë dhe kimisë). Njohuritë e ndryshme që merren në lëndët e biologjisë dhe kimisë ndihmojnë nxënësit për të zhvilluar kuptimin e trurit njerëzor dhe si funksionon ai.

1.4.4 Shoqëria dhe mjedisi

Shkencat sociale

Si të gjitha shkencat sociale ashtu edhe psikologjia ka një interes të përbashkët për mënyrën se si funksionojnë shoqëritë dhe si njerëzit mund të marrin pjesë si qytetarë të rëndësishëm, aktivë, të informuar dhe përgjegjës.

Histori

Historia është një partner i shkëlqyer për psikologjinë sepse psikologjia ka një dimension social-historik. Sjellja shpesh është ritualiste, e ndikuar nga kultura, gjene dhe mjedisi. Shumë ngjarje me rëndësi të madhe historike mund të shqyrtohen duke përdorur teoritë e ndryshme psikologjike. Mënyra se si lidhet psikologjia me faktet e ndryshme historike, ndihmon nxënësit të shohin një dimension tjetër të historisë.

1.4.5 Arte

Psikologjia lidhet me artet duke ofruar mënyra të ndryshme efektive të për të kuptuar dhe analizuar veprat e ndryshme, gjithashtu mund të kontribuojë në zhvillimin e aftësive të tyre të menduarit kritik. Nxënësit mund të zhvillojnë njohuritë, aftësitë apo qëndrimet e tyre duke iu përgjigjur një sërë pyetjesh, si për shembull: Pse u zgjodh kjo temë?; Çfarë mesazhi përcjell?; Si lidhet tema/vepra me realitetin dhe botën ku jetojmë? etj.

1.4.6 Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti

Psikologjia lidhet me sportin duke përdorur teknika dhe metoda për të përmirësuar punën në sporte në grup apo ato individuale. Aspektet psikologjike të ndërthurura në sport ndikojnë në përmirësimin e cilësisë në lëvizjet atletike dhe neutralizimin e efekteve të elementeve stresuese apo shqetësuese që pengojnë performancën në aktivitete të ndryshme.

Psikologjia, si shëndeti, është e interesuar në konceptet, dimensionet e mirëqenies, qëndrimet dhe vlerat, drejtësia sociale, perspektivat socio-ekologjike dhe ndërlidhjet mes individëve, të tjerëve dhe shoqërisë.

1.4.7 Teknologji dhe TIK

Psikologjia dhe proceset e saj i ndihmojnë nxënësit që informacionin e ndryshëm teorik të marrë, ta përdorin në mënyrë sa më efektive dhe krijuese për implikimet e teknologjisë. Gjithashtu psikologjia ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre në teknologji nëpërmjet përvojave të të nxënit.

1.5 Kompetencat e fushës/lëndës dhe tematikat e saj

Procesi i të nxënit në fushën shoqëria dhe mjedisi, në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe, si dhe të kompetencave të tjera. Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatisin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet, kur kjo është e nevojshme.

Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj. dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

Programi i psikologjisë zhvillon kompetencat e mëposhtme:

Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

Zgjedhjet kanë pasoja

Nxënësi:

- njeh dhe vlerëson zgjedhje të rëndësishme të bëra nga individë, komunitete, shtete dhe kombe që kanë ndikuar në jetën dhe të ardhmen tonë;

- analizon kontekstin në të cilin do të bëhen zgjedhjet dhe do të nxjerrë përfundime rreth motiveve dhe qëllimeve të vendimmarrësve;
- heton shembuj të shkaqeve dhe pasojave të zgjedhjeve të veçanta dhe lidh ato zgjedhje me çështjet bashkëkohore;
- përdor kuptimin e tij/saj për zgjedhjet dhe pasojat për të ndërtuar një proces vendimmarrës dhe për të justifikuar një vendim.

Individët kanë të drejta dhe përgjegjësi

Nxënësi:

- njeh dhe vlerëson të drejtat dhe përgjegjësitë e njerëzve që jetojnë në shoqëri;
- analizon kontekstin në të cilin përcaktohen dhe demonstroi të drejtat dhe përgjegjësitë e rëndësishme, interpretimet e tyre të ndryshme dhe nxjerr konkluzione rreth këtyre interpretimeve;
- heton të drejtat dhe përgjegjësitë specifike të individëve dhe lidh këto të drejta dhe përgjegjësi me çështjet bashkëkohore;
- përdorë kuptimin e tij/saj të të drejtave dhe përgjegjësi për të adresuar çështjet bashkëkohore.

Shoqëritë formohen nga besimet, idetë dhe diversiteti

Nxënësi

- njeh dhe vlerëson besime, kontribute dhe ide të rëndësishme të popujve dhe grupeve të ndryshme dhe ndikimin e tyre në individë, komunitete, shtete dhe kombe;
- nxjerr përfundime rreth besimeve, kontributeve dhe ideve të rëndësishme, duke analizuar origjinën dhe kontekstin në të cilin janë arritur këto ideale konkurruese dhe perspektivat e shumta nga të cilat vijnë;
- heton bindjet specifike, kontributet, idetë dhe/ose popullatat e ndryshme dhe i lidh ato besime, kontribute, ide dhe/ose diversitet në çështjet bashkëkohore;
- përdor kuptimin e tij/saj të këtyre besimeve, kontributeve, ideve dhe diversitetit për të justifikuar ose për të përcaktuar se si idealet e komunitetit, shtetit, kombëtare dhe ndërkombëtare formojnë shoqërinë bashkëkohore.

Shoqëritë përjetojnë vazhdimësinë dhe ndryshimin me kalimin e kohës

Nxënësi

- njeh dhe vlerëson vazhdimësinë dhe ndryshimin me kalimin e kohës dhe ndikimin e tij në individë, institucione, komunitete, shtete dhe kombe;
- analizon kontekstin e vazhdimësisë dhe ndryshimit dhe mjetet e reformës, duke nxjerrë përfundime rreth ndryshimeve të kaluara dhe ndryshimeve të mundshme në të ardhmen;
- heton një shembull të vazhdimësisë dhe/ose ndryshimit dhe lidh atë vazhdimësi dhe/ose ndryshim në një çështje bashkëkohore;
- përdor kuptimin e tij/saj për vazhdimësinë dhe ndryshimin për të ndërtuar një model për reformën bashkëkohore.

Marrëdhëniet midis njerëzve, vendeve, ideve dhe mjediseve janë dinamike

Nxënësi:

- njeh dhe vlerëson marrëdhëniet dinamike që ndikojnë jetën në individë, komunitete, shtete dhe kombe;
- analizon kontekstin e marrëdhënieve të rëndësishme dhe nxjerr përfundime rreth një bote bashkëkohore;
- heton marrëdhënien midis njerëzve, vendeve, ideve dhe/ose mjedisit dhe i lidh këto marrëdhënie me çështjet bashkëkohore;
- përdor kuptimin e tij/saj për këto marrëdhënie dinamike për të krijuar një qëndrim personal, komunitar, shtetëror dhe/ose kombëtar.

1.6 Koha mësimore për tematikë

Lënda e psikologjisë zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje në klasën XII. Në klasën XII zhvillohet në 34 javë mësimore me nga 2 orë, pra gjithsej 68 orë. Programi i lëndës së psikologjisë specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë, ku shumica e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë.

34 javë x 2 orë = 68 orë

| Tematika | Orë të sugjeruara |
|--------------------------------------|-------------------|
| Studimi i psikologjisë | 7 orë |
| Biopsikologjia | 19 orë |
| Zhvillimi | 15 orë |
| Njohja | 15 orë |
| Variacionet mes individëve e grupeve | 12 orë |
| Totali | 68 orë |

Rezultatet e të nxënit sipas tematikave të lëndës

Tematika: Studimi i psikologjisë

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me fushën e psikologjisë dhe me zhvillimin që ajo ka pësuar; me çfarë merret psikologjia dhe këndvështrimet në të cilat ajo i sheh fenomenet psikologjike; me degëzimet e psikologjisë dhe me mënyrën se si studiuesit e psikologjisë e pasurojnë diturinë psikologjike.

Tabela 4. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Studimi i psikologjisë

| Rezultatet e të nxënit | | |
|---|--|---|
| Njohuritë | Shkathhtësitë | Qëndrimet/vlerat |
| <p>Hyrje në psikologji</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i psikologjisë si shkencë - Nën fushat kryesore në psikologji <p>Profesioni i psikologut</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mundësitë e karrierës - Aplikimet profesionale të shkencës psikologjike | <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan nën fushat kryesore të psikologjisë; - përshkruan zhvillimin e psikologjisë si një shkencë empirike; - shpjegon rëndësinë e mirëqenies shpirtërore dhe të kujdesit që i duhet kushtuar kësaj. | <ul style="list-style-type: none"> - dallon këndvështrimet e sotme të psikologëve për kuptimin e sjelljes dhe të proceseve mendore; - tregon veçorinë e psikologjisë në studimin e sjelljes dhe të proceseve mendore; - vlerëson rëndësinë e funksionimit psikologjik në jetë. |

Tematika: Biopsikologjia

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me bazat biologjike të sjelljes njerëzore e me themelin kimik të saj, me mënyrën sesi në vihemë e mbahemi në kontakt me botën në të cilën jetojmë, me ndërtimin e aparatit që na ndihmon të kuptojmë botën me të cilën kemi kontaktuar.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me rrugët që ndjekin sinjalet që prej organeve të shqisave e deri në tru; me shqisat e të parit, dëgjuarit, shijuarit, nuhatjes, me perceptimin përkatës dhe me faktorë ndërmjetës në procesin e perceptimit.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me konceptet dhe teoritë mbi motivacionin, me motivet për të ngrënë, pirë e për sukses, me marrëdhëniet dhe hierarkinë e motiveve. Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me natyrën e emocioneve dhe teoritë që i shpjegojnë ato, me mënyrat e shprehjes së emocioneve.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me stresin, stresorët dhe reagimin ndaj tyre, me sistemin imunitar dhe sëmundjet, me marrëdhëniet midis modeleve sjellore dhe sëmundjeve të caktuara, me mbrojtjen nga stresi dhe adoptimin e besimeve dhe të sjelljeve të shëndetshme.

Tabela 5. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Biopsikologjia

| Rezultatet e të nxënit | | |
|--|--|--|
| Njohuritë | Shkathësitë | Qëndrimet/vlerat |
| Baza biologjike të sjelljes <ul style="list-style-type: none">- Struktura dhe funksioni i sistemit nervor- Struktura dhe funksioni i sistemit endokrin- Ndërveprimi midis faktorëve biologjikë dhe sjelljes | <ul style="list-style-type: none">- përshkruan strukturën dhe funksionim e neuronit;- përshkruan organizimin e sistemit nervor;- përshkruan strukturën dhe funksionimin e sistemit endokrin; | <ul style="list-style-type: none">- njeh teknologjitë dhe metodat klinike të studimit të trurit;- shpjegon bashkëveprimin e trashëgimisë me mjedisin në lidhje me sjelljen; |

| | | |
|---|---|---|
| <p>Ndjesia dhe perceptimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Proceset e ndjesisë dhe perceptimit - Aftësitë dhe kufizimet e proceseve shqisore - Ndërveprimi i personit dhe mjedisit në përcaktimin e perceptimit <p>Motivimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Perspektivat mbi motivimin - Fushat e sjelljes së motivuar tek njerëzit <p>Emocionet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Perspektiva për emocionet - Interpretimi dhe shprehja emocionale - Fushat e sjelljes emocionale <p>Shëndetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Stresi dhe përballimi - Sjelljet dhe qëndrimet që nxisin shëndetin | <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan teoritë kryesore për motivacionin; - argumenton nevojën për përmirësimin e funksionimit mendor; - harton plane për përballimin e stresit personal; - shpjegon reagimet fiziologjike dhe psikologjike ndaj stresorëve. | <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon perceptimin dhe bashkëveprimin e personit me mjedisin; - analizon rolin e biologjisë dhe të nxënit në motivacionin dhe emocionet; - analizon aspektet fiziologjike, afektive, kognitive dhe sjellore të emocioneve; - vlerëson rëndësinë e kujdesit për funksionimin mendor; - vlerëson veprime për përmirësimin e shëndetit mendor. |
|---|---|---|

Tematika: Zhvillimi

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me ndikimin e faktorëve gjenetikë në zhvillim, me zhvillimin prenatal, me zhvillimin mendor, emocional, social gjatë foshnjërisë dhe fëmijërisë, me zhvillimin gjatë adoleshencës, me zhvillimin në moshën e rritur.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me biologjinë e motivit seksual, me faktorët socialë e kulturorë me ndikim në seksualitetin, me çrregullimet seksuale, me qëndrimet e shëndetshme seksuale.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me shkollat kryesore të shpjegimit të personalitetit: atë psikodinamike, kognitive, fenomenologjike dhe atë karakterologjike, me vlerësimin e personalitetit.

Tabela 6. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Zhvillimi

| Rezultatet e të nxënit | | |
|--|--|---|
| Njohuritë | Shkathtësitë | Qëndrimet/vlerat |
| Zhvillimi <ul style="list-style-type: none">- Metodat dhe çështjet në zhvillimin e jetës- Teoritë e zhvillimit- Zhvillimi prenatal dhe i porsalinduri- Foshnjëria (d.m.th. dy vitet e para të jetës)- Fëmijëria | <ul style="list-style-type: none">- përshkruan zhvillimin si proces jetësor;- tregon teknikat për grumbullimin e të dhënave për zhvillimin njerëzor;- përshkruan teoritë për zhvillimin njerëzor;- përshkruan mjetet në përdorim për vlerësimin e personalitetit;- ndërton plane për zhvillimin e personalitetit individual. | <ul style="list-style-type: none">- diskuton për temat më të mëdha lidhur me zhvillimin: rolin e mjedisit e trashëgimisë, vazhdimësinë/ndërprerjes së zhvillimit, qëndrueshmërinë/paqëndrueshmërinë e zhvillimit, zhvillimin në periudha kritike;- diskuton për teoritë për kuptimin e personalitetit;- vlerëson periudhën personale të zhvillimit dhe rëndësinë që ka ajo për jetën; |
| Personaliteti <ul style="list-style-type: none">- Perspektiva për personalitetin- Vlerësimi i personalitetit | | |

| | | |
|---|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Çështjet rreth personalitet | | <ul style="list-style-type: none"> - mban qëndrime të mirinformuara në lidhje me krizat e moshës së vet; - zhvillon sjellje të shëndetshme në lidhje me substancat, seksin, ushqimin. |
|---|--|---|

Tematika: Njohja

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me kuptimin mbi vetëdijen, me gjumin dhe ëndrrat, me hipnozën dhe gjendjet që krijohen prej drogave psikoaktive.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me modelet klasike të të mësuarit: me nxënien e sinjaleve dhe të shoqërimeve (kushtëzimi klasik i Pavlovit) e me të nxënit e pasojave të sjelljes (kushtëzimi veprues i Skinnerit), me të nxënit me imitim, duke bërë, duke kuptuar. Të gjitha këto do të shihen të lidhura me sjelljen e nxënësve në kontekstin e tyre.

Në këtë tematikë nxënësit do të marrin informacion për natyrën e kujtesës e për mënyrën se si ndodh të regjistrojmë informacion të ri, për faktorët me ndikim në punën e kujtesës, për mënyrat me të cilat mund të përmirësojmë vëllimin dhe cilësinë e kujtesës sonë e të administrojmë harresën, për bazat biologjike të kujtesës etj.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me kuptimin mbi inteligjencën dhe mbi teoritë mbi të, me funksionet bazë të të menduarit; me përfaqësimet mendore e me strategjitë e të menduarit, me testimin e inteligjencës, me situatën problemore e me marrjen e vendimeve.

Tabela 7. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Njohja

| Rezultatet e të nxënit | | |
|---|--|--|
| Njohuritë | Shkathtësitë | Qëndrimet/vlerat |
| Të mësuarit - Kushtëzimi klasik - Kushtëzimi veprues | - përshkruan kuptimin dhe parimet e të nxënit; - rendit pjesët përbërëse të të mësuarit kognitiv; | - argumenton për rolin e biologjisë dhe të kulturës në procesin e të nxënit; - analizon metodat e përmirësimit të kujtesës; |
| Ndërgjegjja/vetëdija | | |

| | | |
|--|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhëniet midis proceseve të ndërgjegjshme dhe të pavetëdijshme - Karakteristikat e gjumit dhe teoritë që shpjegojnë pse flemë dhe ëndërrojmë - Kategoritë e drogave psikoaktive dhe efektet e tyre | <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan mënyrën si bëhet regjistrimi dhe përdorimi i informacionit të kujtesës; - përshkruan sistemet e kujtesës afatshkurtër e afatgjatë; - rendit tiparet strukturore të gjuhës; - përshkruan teoritë dhe stadet e zhvillimit të gjuhës; - përshkruan natyrën e ndërgjegjes; - përshkruan drogat psikoaktive dhe rolin e tyre në psikikë; - përshkruan natyrën e inteligjencës dhe si testohet ajo; - analizon marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë dhe mjedisit në diferencat individuale. | <ul style="list-style-type: none"> - diskuton për strategjitë dhe pengesat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve - shpjegon lidhjet ndërmjet të menduarit dhe gjuhës; - njeh karakteristikat dhe teoritë e gjumit, të ëndrrave dhe të hipnozës; - tregon pse dhe si maten veçoritë individuale; - zhvillon plane individuale për përmirësimin e kujtesës dhe të të menduarit; - zgjidh probleme mbi bazën e njohurive të fituara. |
| <p>Kujtesa</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e kujtesës - Ruajtja e kujtesës | | |
| <p>Inteligjenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Perspektivat për inteligjencën - Vlerësimi i inteligjencës - Çështje në inteligjencë | | |
| <p>Të menduarit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Elementet bazë që përbëjnë mendimin - Pengesat që lidhen me mendimin | | |

Tematika: Variacionet mes individëve e grupeve

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me kuptimin mbi sjelljen jonormale, me shpjegimin dhe klasifikimin e sjelljes jonormale; me trajtimin e saj.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me fenomenet psikologjike që aktivizohen prej të qenit në shoqëri, posaçërisht me perceptimin social, qëndrimet, paragjykimet, tërheqjen reciproke, bindjen, agresivitetin, altruizmin dhe proceset grupale.

Fokusi i kësaj tematike do të jetë sjellja e nxënësve në kontekstet e tyre tipike dhe mundësitë për të përmirësuar këtë sjellje duke zhvilluar tolerancë dhe mirëkuptim.

Tabela 8. Rezultatet e të nxënit për tematikën: Variacionet midis individëve dhe grupeve

| Rezultatet e të nxënit | | |
|--|--|---|
| Njohuritë | Shkathhtësitë | Qëndrimet/vlerat |
| Çrregullime psikologjike <ul style="list-style-type: none">- Perspektivat mbi sjelljen jonormale- Kategoritë e çrregullimeve psikologjike | <ul style="list-style-type: none">- përshkruan karakteristikat dhe origjinën e sjelljes anormale;- rendit metodat e përdorura për studimin e sjelljes anormale; | <ul style="list-style-type: none">- zotëron njohuri se kush i trajton çrregullimet e sjelljes;- diskuton për aspektet etike të trajtimit të sjelljes së çrregulluar; |
| Trajtimi i çrregullimeve psikologjike <ul style="list-style-type: none">- Perspektivat për trajtimin- Kategoritë e trajtimit dhe llojet e ofruesve të trajtimit- Çështjet ligjore, etike dhe profesionale në trajtimin e çrregullimeve psikologjike | <ul style="list-style-type: none">- shpjegon kategoritë kryesore të sjelljes anormale;- përshkruan metodat më të shquara për trajtimin e sjelljes anormale; | <ul style="list-style-type: none">- mban qëndrimin e tij për gjykimin social dhe qëndrimet shoqërore;- analizon ndikimin shoqëror dhe marrëdhëniet shoqërore;- dallon sjellje të shëndetshme mendore; |

| | | |
|---|--|--|
| <p>Ndërveprimi social</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohjen shoqërore - Ndikimi social - Marrëdhëniet shoqërore <p>Diversitetisociokulturor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diversiteti social dhe kulturor - Diversiteti midis individëve | <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan kategoritë shoqërore dhe kulturore. | <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson shëndetin mendor; - zhvillon sjellje jostigmatizuese ndaj personave me shqetësime mendore; - vlerëson rolin e psikologut dhe të psikiatrit; - demonstroi qëndrime tolerance dhe joparagjyquese në jetën personale. |
|---|--|--|

Udhëzime metodologjike

Metodologjia e zbatimit të kurrikulës bërthamë luan rol thelbësor për përmbushjen e qëllimeve të fushës shoqëria dhe mjedisi. Të nxënit përmes kësaj fushe mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar njohuri, aftësi, shkathhtësi e qëndrime të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen.

Mësuesi angazhon nxënësit në një proces në të cilin ata parashtrojnë pyetje dhe formulojnë përgjigje, inkurajon frymën e mendimit krijues dhe kritik duke nxitur diskutimin ndërmjet tyre, duke inkurajuar pavarësinë e nxënësve, iniciativën e tyre, ndërveprimin. Në këtë qasje mësuesi nxit shpirtin udhëheqës të nxënësve, bashkëpunimin, tolerancën, vetëbesimin dhe shpirtin sipërmarrës që reflektohet në rezultatet e të nxënit.

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme të punës me nxënës, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve që integrojnë njohuritë përkatëse me shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet. Disa nga metodat, teknikat dhe strategjitë e sugjeruara në këtë fushë janë:

-) diskutimet;
-) debatet;
-) vrojtimit;
-) intervistat;
-) ekskursionet;
-) konkurset;
-) projektet kurrikulare dhe ndërkurrikulare etj.

Ky program është një dokument zyrtar. Bashkë me të ekzistojnë dhe përdoren edhe një sërë dokumentesh të tjera. Të gjitha këto formojnë një pjesë përbërëse të kurrikulës së formimit shoqëror të nxënësve që ndjekin gjimnazin. Hartimi i këtij programi mban parasysh edhe lëndët e tjera me të cilat lidhet drejtpërdrejt dhe tërthorazi ky program.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura. Tek korniza kurrikulare vëmendje e veçantë u duhet kushtuar:

- a. synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- b. synimeve të tematikave ndërkurrikulare;
- c. vlerësimit të nxënësit;
- d. parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin programet lëndore të lëndës së sociologjisë dhe biologjisë. Është mirë që përdoruesit e dokumenteve të përmendura të kenë njohuri edhe për standardet e fushave të tjera të të nxënësve, si dhe për programet e lëndëve të tjera të të njëjtit vit.

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësisë së përgjithshme të vetëshprehjes;
- aftësisë së zgjidhjeve problemore;

- aftësisë për mendim kritik dhe krijues;
- aftësive aplikative të lëndës;
- formimit të qëndrimeve tolerante ndaj diversitetit, gjërave që janë ndryshe nga tona, ato që pëlqejmë zakonisht.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj. Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Udhëzime për vlerësimin

Të përgjithshme

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të nxënësve në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësit të kompetencave të fushës shoqëria dhe mjedisi. Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale që përfshijnë shoqërinë dhe mjedisin si pikënisje për vlerësimin e nxënësve.

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit ka për qëllim përcaktimin e ecurisë së nxënësit në përvetësimin e lëndës dhe nota e tij duhet të shprehë pikërisht këtë përparim. Pra nuk kërkohet që nota të shprehë vetë sasinë e njohurive të fituara, por edhe faktin se sa i zbaton nxënësi në diskutime, punë me shkrim, ekspedita njohurite e mësuara në lëndën e psikologjisë. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashton peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti. Gjithashtu mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në evidencë për secilën orë mësimore.

Herëpashere mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij. Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup. Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa tema,

të cilat i bashkojnë rezultatet e ndërlidhura të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet e shkurtra për një rezultat të veçuar të të nxënit, deri tek ato një orësh: teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe testimi me shkrim në fund të çdo periudhe. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to. Mësuesi vlerëson gjithashtu nxënësit përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësve dhe siguron një tablo të plotë të arritjes së tyre. Puna e mbledhur ofron të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Një mundësi vlerësimi dhe vetëvlerësimi është portofoli i nxënësit, që është një përmbledhje e punimeve për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi bën rekomandimet e tij.

Të veçanta

Standardet e përmbajtjes së lëndës së psikologjisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: informacionin, aftësitë për aplikimin e tij dhe qëndrimet jetësore të influencuara nga lënda. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për formimit personal dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve pasqyron nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

Fitimi i njohurive (informacioni), i aftësive aplikative dhe zhvillimi i qëndrimeve jetësore realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi etj. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore, në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë. Për këtë arsye, një mundësi e mirë për të vlerësuar aftësitë intelektuale, në procesin e zbatimit të njohurive dhe të jetesës së shëndetshme, janë projektet, që përfundojnë me një produkt të caktuar, për shembull, me një portofol individual, grupi ose klase.

Mësimdhënia e psikologjisë në shkollën e mesme (aktualisht) kryhet edhe prej mësuesve që nuk kanë një formim e diplomim specifik në fushën e psikologjisë, por janë të formuar në shkencat sociale. Për këtë arsye mësimdhënësit e kësaj lënde të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që u krijohen të diskutojnë, të shkëmbejnë eksperiencat me njëri tjetrin, të vendosin dhe të zhvillojnë kontaktet me psikologët e shërbimit psikologjik shkollor.

Këto hapa do t'i ndihmojnë ata:

- a. të zotërojnë metodën e kërkimit dhe shkathësitë për të kërkuar në psikologjinë e jetës së përditshme;
- b. të thellojnë kuptimin që kanë për çështjet psikologjike ose aspektet psikologjike të çështjeve komplekse;
- c. të lidhin çështjet e psikologjisë me ato të sociologjisë dhe biologjisë së njeriut;
- d. të familjarizohen me këndvështrimin psikologjik të çështjeve tashmë të njohura në këndvështrime të tjera.

Materialet dhe burimet mësimore

Një rol të rëndësishëm në procesin e të nxënit në shkencat e natyrës zënë mjetet mësimore. Ato kanë funksione të ndryshme si: informimi, motivimi, konkretizimi, demonstrimi, ilustrimi, plotësimi i të dhënave, shpjegimi i përmbajtjes mësimore, nxitja e aftësive të të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimi dhe përsosja e aftësive, racionalizimi i kohës, bashkëveprimi nxënës-mësues etj. Ato duhet të sigurohen dhe të zgjidhen në sasinë dhe cilësinë e duhur. Në planin mësimor ditor ato planifikohen për çdo temë, vetëm se mësuesi duhet të njohë mirë metodikën e demonstrimit dhe të aktivizimit të nxënësve nëpërmjet tyre.

Që këto mjete të jenë sa më funksionale në orën e mësimit, duhet të plotësojnë disa kërkesa metodike, shkencore, psikologjike, estetike, teknike dhe ekonomike. Më poshtë janë dhënë disa nga mjetet më të përdorshme.

Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletorja e punës, libri i mësuesit, udhëzuesi profesional, fjalorët, gazetatat, revistat, atlasat, materialet psikopedagogjike, enciklopeditë etj.

Mjetet pamore-dëgjimore: televizor, film, video, video-projektor, videokasetë, kompjuter, tablet, internet, teletekst, CD, e-mail.

Mjedisi mësimor: klasa, laborator, kabinetet e punës etj.

Këto burime duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga mësuesit e fushës së shkencave shoqërore si një pjesë e planit të tyre për shkencën. Plani duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësin në veprimtarinë e tij gjatë hulumtimit të kësaj fushe.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut:

-) Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
-) Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet e web-it të shkencës dhe të teknologjisë, të rekomanduara nga mësuesi.

-) Përdorimi i CD-ROM-it për ruajtjen e informacionit të dëshiruar, prezantime temash, projektesh, videosh, figurash.
-) Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm software-sh.
-) Paraqitja grafike e të dhënave.